



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	<b>Bali Muharremaj</b> , Kryetar i Komunës së Suharekës <b>Bexhet Kuçi</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	<b>Elbert Krasniqi</b> , Ministër i MAPL-së <b>Jeton Qela</b> , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	<b>Erbilin Hetemi</b> , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	<b>Xhevat Tafa</b> , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit <b>Vjosa Ahmetaj</b> , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Suharekës

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 01-Nr-016-9866 për miratimin e raportit të komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave

I miratuar më datë: 26.02.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 27.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026, ka miratuar Vendimin 01-Nr-016-9866 për miratimin e raportit të komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave.

MAPL, konstaton se Vendimi 01-Nr-016-9866 për miratimin e raportit të komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave, është në kundërshtim me procedurat e dhënies së pronës së komunës në shfrytëzim të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe me Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përkatësisht me paragrafin 3 të nenit 22 sipas të cilit: *“Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkalluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës”,* dhe me paragrafin 4 të nenit 22 sipas të cilit *“Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit”.*

Në rastin konkret vazhdimi i afatit prej një (1) viti, për përmbushjen e kontratës me qëllim pajisja me leje të ndërtimit dhe realizimi në tërësi të investimeve, mund të behet nga Kryetari i Komunës vetëm për përfituesit të cilët janë shfrytëzues të parcelave dhe të cilët kanë kontratë valide, e jo për përfituesit të cilët nuk e kanë pronën në shfrytëzim apo nuk kanë kontratë valide, dhe vlen të ceket se nuk është përgjegjësi e Kuvendit të Komunës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Suharekës duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.